



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo



Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac / Municipality Rahovec
Zyra për Informim

REPUBLICA E KOSOVES / REPUBLICA OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNES / KABINET PREDSIEDA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR'S CABINET

Njësi Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 2487 Nr. i faq./Br.str./No.pg 20
Data/Datum/Date 22 / 7 / 22
RAHOVEC / ORAHOVAC

Data/Date:	22.07.2022
Nga/Od/From	Zyra për Informim
Për/Za/To:	Smajl Latifi, Kryetar i Komunës së Rahovecit
CC	Kryesuesi i Kuvendit Komunal të Rahovecit, Defrim Kafexhiu
Tema/Subjekat/Subject	Raporti për konsultimin publik për projekt buxhetin e vitit 2023

Ky raport është përgatitur duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ (MAPL) Nr. 06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në komuna me theks neni 5. Zbatimi i standardeve të konsultimit publik dhe neni 17 Mbledhja e komenteve, komunikimi dhe adresimi i tyre.

Duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ (MAPL) NR. 06/2018 për STANDARDET MINIMALE TË KONSULTIMIT PUBLIK NË KOMUNA, Udhëzim Administrativ ky që ka për qëllim nxitjen dhe sigurimin nga ana e autoriteteve lokale të pjesëmarrjes së qytetarëve dhe palëve të tjera të interesuara gjatë procesit të politikëbërjes dhe vendimmarrjes në nivel lokal, të promovoj transparencë komunale, si dhe të ndikoj në zhvillimin e politikave të qëndrueshme në interes të përgjithshëm, Kuvendi Komunal i Rahovecit, respektivisht Komiteti për Politikë dhe Financa dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa mbajtën konsultimin publik për projekt buxhetin e vitit 2023.

Konsultimi publik filloi në orën: 10:00

Konsultimin e kryesuan:

- Kryesuesi i Kuvendit z. Defrim Kafexhiu, dhe
- Drejtori i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, z. Afrim Limani

Nga radhët e Komitetit për Politikë dhe Financa ishin prezent:

1. Burim Krasniqi,
2. Besmira Bytyqi,
3. Melinda Iska.

Të pranishëm në konsultim ishin dhe kryetarët e fshatrave dhe lagjeve urbane të qytetit.

KOMENTET

Adrian Sharku-Përshëndetje, jam Adrian Sharku, përfaqësues i organizatës GRAPELAND. Projekti Grapeland u punua para 3 viteve saktësisht edhe deri tash nuk kemi marrë asnjë përgjigje se a do të vazhdojë apo jo, kemi shumë pyetje nga qytetarët dhe arsyja e pjesëmarrjes sonë këtu është a po e jetësojmë Grapelandin a dojmë me e qit në buxhetin e vitit 2023.

Mirsad Qehaja: Kërkesat që i ka në nevojë fshati Retijë të Ulët:

- Mermetimi i objektit të shkollës,
- Parku në hyrje të fshatit,
- Mirëmbajtja e rrugës gjatë sezonit veror,
- Kubëzimi i rrugëve afro 700-800 metra,
- Ngjyrosjen e murit te varrezat,
- Pastrimi i gropes skeptike,
- Transporti i nxënësve për Piranë.

Murat Kryeziu kryetar i këshillit të fshatit Xerxë– Përshëndetje të nderuar të pranishëm. Kam një pyetje Shkolla e Xërxës, është ndërtim i ri, a është ndarë buxhet dhe sa është ndarë për vitin 2023 dhe nëse është bërë projekti me kë është konsultu projektuesi dhe me çfarë propozime u bë ky projekt sepse është shumë i papranueshëm për fshatin Xerxë.

Tema	Zyra	Pjesëmarrës	Vendi Data	Komentet	1.Njoftimi 2.Lajmi 3.Procesverbali
Konsultimi publik për projekt buxhetin e viti 2023	Zyra e Kuvendit Zyra për Informim	F M T 3 15 18	Salla e Kuvendit 24.06.2022	3 komente 2 të pranuar 1 të papranuar	1. https://kk.rks-gov.net/rahovec/wp-content/uploads/sites/23/2022/06/NJOFTIMI-KONSULTIM-PUBLIK-SHQIP.pdf 2. https://www.facebook.com/rahoveckomuna/posts/pfbid0PzWwPAAEcY2HLjc4iBtS4VsPTMsAJYcw172af8by3xbRxQ6DXJdRGDwjQ6DE9Ebl 3. https://kk.rks-gov.net/rahovec/wp-content/uploads/sites/23/2022/07/PROCESVERBAL-I-KONSULTIMIT-PUBLIK-PER-PROJEKT-BUXHETIN-2023.pdf

Bashkangjitur në këtë raport janë edhe këto dokumente:

1. Njoftimin për mbajtjen e konsultimit publik
2. Lista e nënshkrimeve të qytetarëve pjesëmarrës në konsultimin publik
3. Lista e zyrtarëve pjesëmarrës në konsultimin publik

Blerta Gashi

Zyrtare për Informim

Zyrtare për menaxhimin e Platformës për Konsultime publike

